



TERMA REFERENCE

ZHVILLUES DHE EDITUES I PËRMBAJTJES SË PLATFORMËS WWW.NOHATESPEECH.AL

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH POZICIONIT TË PUNËS

Lloji i kontratës: Ekspert me kohë të pjesshme- Kontratë shërbimi

Kohëzgjatja e kontratës: 60 ditë pune (Prill 2021-Dhjetor 2021)

Autoriteti Kontraktues: Organizata Përtej Barrierave

Nr i ToR: BBA/03/2021

Baza e punës: Në distancë/online

Gjuha e kërkuar: Shqip dhe Anglisht

Afata i fundit i aplikimit: 25 Mars 2021, Ora 16:00

Data e fillimit të kontratës: 1 Prill 2021

Mbi projektin

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe



FOL kundër gjuhës së urrejtjes është një projekt i cili ka si qëllim të krijojë një mekanizëm kombëtar gjithëpërfshirës online, kundër gjuhës së urrejtjes me synimin që të informojë, të edukojë, të mbledhë të dhëna dhe të forcojë kapacitetet e praktikuesve në adresimin e gjuhës së urrejtjes.

Projekti synon që të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe të hapet një diskurs shoqëror për të ekspozuar rastet e gjuhës e urrejtjes, duke bërë thirrje për një qasje sektoriale dhe një mjedis për zhvillimin e narrativave në luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Ky projekt zbatohet nga Organizata Përtej Barrierave dhe është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës.

Objektivat e Projektit

- Të informojë dhe të edukojë publikun me njohuri në veprimin kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në Shqipëri duke përdorur një grup aktivitetesh dhe ndërhyrjesh të personalizuar për grupe të ndryshme të synuara.
- Të krijojë një mekanizëm kombëtar interaktiv dhe gjithëpërfshirës online kundër gjuhës së urrejtjes, me një qëllim shumëfunksional në informim, edukim, mbledhjen e të dhënave dhe forcimin e kapaciteteve të praktikuesve në adresimin e gjuhës së urrejtjes.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Qëllimi i detyrës

Platforma kombëtare dixhitale ndërvepruese për gjuhën kundër urrejtjes në Shqipëri është një mjet promovues, informativ dhe lehtësues ndaj këtij fenomeni. Platforma në internet synon të plotësojë boshllëqet e identifikuar më parë duke krijuar gjithashtu një hapësirë kolektive ku të gjithë mund të ndihen të lirë dhe të sigurt për t'u informuar, për të mësuar më shumë dhe për të mbështetur viktimat e gjuhës së urrejtjes.





Për të përmbushur këtë detyrë Organizata Përtej Barrierave po kërkon një ekspert për **Zhvillimin dhe editimin** e përmbajtjes së platformës e cila do të jetë në gjuhën Shqipe.

Ekspertiza e kërkuar

Disa nga funksionet kryesore të kësaj detyre konsistojnë në:

- Zhvillimin dhe krijimin e materialeve që promovojnë dhe nxisin luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri;
- Përkthimi i lajmeve, përmbledhjeve dhe materialeve mbi gjuhën kundër urrejtjes në shqip;
- Përmbledhja dhe përshtatja e lajmeve dhe botimeve para publikimit të tyre në faqen e internetit të platformës;
- Marrja dhe përditësimi i informacionit mbi tematikën e gjuhës kundër urrejtjes në vend dhe jo vetëm;
- Shfaqja dhe shpërndarja e aktiviteteve të vetë projektit, etj.
- Përditësimi i platformës me informacione të përshtatshme dhe ndihmëse në fushën edukative;

Kohëzgjatja e ekspertizës

Detyra	Ditët e punës	Tabela indikative	Vendi i punës
Përgatitje e materialeve dhe detyrave të lartpërmendura	60 ditë	1 Prill 2021 31 Dhjetor 2021	Online

Kujt i përgjigjet





- Eksperti/ja mban komunikim të drejtëpërdrejtë me Kordinatoren e projektit dhe Menaxheren e Programeve në Përtej Barrierave dhe merr detyrat prej tyre, duke bashkërenduar punën me aktivitetet aktuale të vetë projektit;

3. AFTËSITË DHE PËRVOJA E KËRKUAR

Kualifikimi akademik

- Diplomë Universitare: shkencat shoqërore ose në fusha të tjera të ngjashme.

Eksperienca e punës

- Përvojë të mëparshme në fushën e luftës kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri;
- Njohuri të mira të fushatës dhe burimeve të No Hate Speech të Këshillit të Europës;
- Eksperiencë të mëparshme në fushën e gjuhës kundër urrejtjes, si dhe pjesëmarrje në evente apo trajnime mbi këtë aspekt.
- Aftësi të shkelqyera në përmbledhje dhe editim të teksteve edukative;
- Nivel i lartë i aftësive të organizimit dhe menaxhimit të kohës;

Gjuha

- Aftësi shumë të mira në të folur dhe në të shkruar në Shqip dhe në Anglisht;

Procedura e aplikimit:

Kandidatët e interesuar dhe të kualifikuar duhet të aplikojnë duke dërguar dokumentat e mëposhmit:

- Letër motivimi që shpjegon pse jeni kandidati/ja i/e duhur për këtë pozitë (maksimumi 1 faqe)



- CV/Portofoli i ofruesit të shërbimit (demonstrimi i punës së mëparshme në fushën përkatëse përmes punëve të ngjashme si raporte, trajnime shkrime, etj.)
- Curriculum Vitae CV

Aplikimet do të dorëzohen vetëm përmes postës elektronike.

Nëse jeni të interesuar për të aplikuar për këtë pozicion dhe ju i përmbushni të gjitha kriteret, ju lutem dërgoni aplikimin tuaj që përmban të gjitha dokumentat e nevojshme, në email, në office@beyondbarriers.org, dhe irena.topalli@beyondbarriers.org duke vënë në subjekt **BBA/03/2021 dhe (Emrin/Mbiemrin tuaj)**, jo më vonë se **data 25 Mars 2021, ora 16:00**

Përzgjedhja dhe njoftimi

Aplikantët do të vlerësohen për dy aspektet si më poshtë:

- Aspektet teknike sipas procedurës së aplikimit
- Përmbushja e aftësive dhe përvojës së kërkuar

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë do të njoftohen me email brenda datës **29 Mars 2021**.

Për pyetje mund të na drejtoheni me anë të postës elektronike brenda datës 22 Mars 2021, ora 16:00 në kontaktet:

Irena Topalli – Koordinator e projektit - E-mail: irena.topalli@beyondbarriers.org

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe